



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 308/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10/05/2016 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr.991 prot., dt. 22.04.2016”.

Ankimues:

BO “Company Riviera 2008” sh.p.k. & “Kevin Konstruksion” sh.p.k.

Adresa: Rr Nacionale Kamëz-Fushë Krujë, Kthesa e Valiasit Nr.1 në zonë industriale 2066 Nr. Pasurie 62/35, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Adresa: Rr.Sami Frashëri Nr.10

Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:


I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.02.2016 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e hapur” me Nr. Ref 24493-02-18-2016 me objekt “Rikonstruksion i rruges autostrade - fshati Bulo” me fond limit 72,011,026 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.03.2016, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 07.04.2016 bashkimi i operatorëve ekonomik “Company Riviera 2008” sh.p.k. & “Kevin Konstruksion” sh.p.k. është njoftuar me anë të S.P.E. për skualifikimin e ofertës së tyre në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. Ref 24493-02-18-2016 me objekt “Rikonstruksion i rruges autostrade - fshati Bulo” me fond limit 72,011,026 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.03.2016, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.3. Në datën 13.04.2016 bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertë së tyre.

II.4. Në datë 14.04.2016 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.498/2 datë 13.04.2016 i kthen përgjigje bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues duke mos pranuar ankesën e tyre.

II.5. Në datën 22.04.2016 pala ankimuese ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.6. Në datën 26.04.2016 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në datën 09.05.2016, bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. Ref 24493-02-18-2016 me objekt “Rikonstruksion i rruges autostrade - fshati Bulo” me fond limit 72,011,026 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.03.2016, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Company Riviera 2008” sh.p.k. & “Kevin Konstruksion” sh.p.k. për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. Ref 24493-02-18-2016 me objekt “Rikonstruksion i rruges autostrade - fshati Bulo” me fond limit 72,011,026 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.03.2016, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Komisioni Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, K.P.P. do t’i referohet situatave analoge me çështjet gjyqësore për të cilat parashikohen në nenin nenin 201 “Heqja dorë nga gjykimi dhe nga e drejta e padisë” të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i procedurës civile” i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“Paditësi në çdo fazë të gjyimit mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Në këtë rast gjykata vendos pushimin e gjyimit [.....]”

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimin e tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik sjell si rrjedhojë pushimin e procedimit administrativ.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pushojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. Ref 24493-02-18-2016 me objekt “Rikonstruksion i rruges autostrade - fshati Bulo” me fond limit 72,011,026 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.03.2016, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 991 protokolli

Datë 22.04.2016

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Juliana Hoxha

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Kryetar
Gentian Këri

